



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:214077

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06325875

KF.nr.381/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Posta e Kosovës” Sh.A me numër unik identifikues 811285205 dhe me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ekrem Ademi jurist i diplomuar, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti rivlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Ekrem Ademi jurist i diplomuar, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur me datë 19.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Posta e Kosovës” Sh.A me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.223/2021 i datës 23.08.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 24.09.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër vendimit nr.223/2021 i datës 23.08.2021 të Administrata Tatimore e Kosovës, për shkak të shkeljeve të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit jo të plot dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet në tërësi padia dhe të anulohet vendimin nr.223/2021 i datës

23.08.2021 si i kundërligjshëm. Në seancën e shqyrtimit kryesor publik përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbeten pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe pranë deklaramëve respektivisht thënieve nga seanca e kaluar duke i propozuar gjykatës që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses Posta e Kosovës Sh.A. Si palë paditëse deklarojmë se kemi pranuar ekspertizën financiare të përgatitur nga eksperti z.A.M. i cili mendimin dhe konstatimin e tij e ka paraqitur me nder dhe në pajtim me rregullat e shkencës dhe profesionit. Të njëjtën ekspertizë e pranojmë në tërësi duke kërkuar nga gjykata që e njëjta të administrohet dhe të pranohet si provë materiale me rastin e vendosjes në këtë çështje kontestimore. Po ashtu konsiderojmë se paditura gjatë inspektimit të kryer tek paditësja ka bërë një vlerësim të gabuar kur ka vendosur si në vendimin e atakuar me ç ‘rast ka përfshirë një shumë të tepruar që nuk është në përputhje me të hyrat financiare të Postës së Kosovës për vitin 2020. Për më tepër siç është theksuar edhe nga Ministria e Ekonomisë Posta e Kosovës nuk është subvencionuar për mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga ofrimi i shërbimit universal postar çka tregon se në të dhënat e qarkullimit të hyrave financiare nuk mund të përfshihej si bazë për rritjen e qarkullimit të pretenduar nga e paditura ATK. Duke marrë parasysh të gjitha këto konstatime si palë paditëse kërkojmë nga gjykata që padia të aprovohet në tërësi dhe që vendimi i të paditurës këtu ATK të anulohet ashtu që ta njoh vlerësimin e ekspertizës si bazë dhe fakt të pamohueshëm në këtë proces. Sa i përket përgjigjes të cilën e pranova sot në këtë seancë e cila është dërguar nga e paditura ATK të njëjtën e kundërshtojmë dhe atë mbi bazën se të gjitha çështjet konsiderojmë se ekspertiza e pranuar ka sqaruar në mënyrë të qartë dhe në mënyrë konkrete. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura gjatë kontrollit të bërë tek paditësi nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të kontrollit tatimor dhe se nuk qëndrojnë konstatimet për rritjen e qarkullimit shtesë ndaj Postës së Kosovës përkatësisht prezantimi i të hyrave shtesë në vlerën prej 4,298.202.52 euro me pasqyrat financiare të paditëses për vitet që përfundon 31.12.2020 është i pa bazuar dhe i pa drejtë e fakt të cilin e ka vërtetuar edhe ekspertiza financiare e datës 18.06.2024 punuar nga eksperti A.M.. Në bazë të provave të dorëzuara dhe të administruara nga gjykata konsiderojmë se ATK gjatë kontrollit ka marrë vendim të gabueshëm me rastin e paraqitjes së të dhënave të rritjes të qarkullimit shtesë për vitin 2020. Bazuar në provat dhe faktet që janë administruar gjatë këtij procesi gjyqësor i propozojmë gjykatës që padia e paditëses Posta e Kosovës sha të aprovohet si e bazuar ashtu që të anulohet vendimi i DA të ATK-së nr. 223/2021 datës 23.08.2021 si i kundërligjshëm. Po ashtu kërkojmë që e paditura të obligohet të mbulojë shpenzimet e procedurës dhe atë: për pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumë prej 50 euro, për ekspertizën financiare në vlerë prej 400 euro e gjithsej në total shumën prej 450 euro.

E paditura në përgjigje në padi të datës 30.08.2023, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitur në padi, si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe ka vlerësuar se vendimi i kundërshtuar, ka mbështetje ligjore, faktike dhe është në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutja ka theksuar se rritja e qarkullimit shtesë ndaj paditësi përmes kontrollit nga ATK, nga vlera 2,068,202.81 euro në vlerë 4,28,299.52 euro, ka rezultuar pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga paditësi në procedurën e kontrollit por që e cila ka mbet në fuqi edhe pas analizimit të këtyre provave nga ana e organit të shkallës së dytë të ATK-së (DA-ja). Trajtimi i këtyre të hyrave nga subvencionimi i Qeverisë së Kosovës-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, sipas marrëveshjes që Posta e ka me MZHE janë të përfshirë tek kontoja 4902 si të hyra nga subvencionimi për shërbime universale postare për vitin 2020 e të cilat kapin shumën prej 4,298,299.52 euro. Paditësi në periudhën tatimore 2020, ka ndarë shpenzimet postare në dy kategori, si shpenzime universale postare pas subvencionim dhe shpenzimet universale postare me subvencion. Pas analizimit nga ana e ATK-së së shpenzimeve me të lartë si zërin e pagave paditësi, pagat e shërbimeve universale postare me subvencion i ka ndarë në konto të veçanta kontabël, ndërsa pagat pa subvencionim të shërbimeve universale postare i ka njohur bashkë me pagat e shërbimeve tjera postare, pra në kuadër të shpenzimeve të pagave pa subvencion ka edhe paga të shërbimeve universale postare që janë objekt i subvencionimit të paraqitur bashkë në pagat e shërbimeve tjera postare. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me parashtesën e datës 16.09.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Po ashtu me këtë parashtesë e ka kundërshtuar në tërësi ekspertizën financiare të datës 18.06.2024 për faktin se nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike. Gjithashtu Gjykatës i ka propozuar që ta lë në fuqi Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.223/2021 i datës 23.08.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë të provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 19.09.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendim nr. 223/2021 datë 23.08.2021, Raporti i kontrollit 25.05.2021, Faturë nr. 01-12-SHUP 2020, Marrëveshje në mes të Ministrisë për Zhvillimin Ekonomik dhe NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A e datës 06.02.2014, Përgjigje në padi e datës 30.08.2023, Vendimi i ZGJONA nr.0536/2021, Listë distribuimi datë 22.07.2021-Kërkesa për informata shtesë nga DA, përgjigje nga DTM, Ekspertizë financiare datë 18.06.2024 dhe shkresat nga shtojca e së njëjtës.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjet në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se kontrolli ka filluar me datë 22.04.2021 dhe përmes formës së kërkesës AU003 me datë 26.04.2021 subjekti është caktuar për kontroll, me datë 25.05.2021 është realizuar raporti i kontrollit me objekt kontrolli CD (TAK) viti 2020, ku janë konstatuar ndryshime pas përfundimit të kontrollit edhe atë rritje e qarkullimit dhe mos pranimit të shpenzimeve. Nuk është kontestues as fakti se paditësi ka parashtruar ankesë me datë 25.06.2021, me të cilën e ka kontestuar raportin e kontrollit nr.2/2021 të datës 25.05.2021 të lëshuar nga Administrata Tatimore. Po ashtu jo kontestuese mbetet edhe fakti se Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave me datë 23.08.2021 ka marrë vendimin nr.223/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 24.09.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë gjykatës.

Nga ekzaminimi i aktvendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës e ka refuzuar ankesën nr.223/2021 e datës 25.06.2021 dhe Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë për periudhat e kontrollit i ka vërtetuar si të bazuar me arsyetim se DA nga analizë bërë dosjes dhe sqarimeve shtesë të pranuar nga kontrolli vërteton se tek zërat të cilët janë të përfshirë tek kontoja 4902- të hyrat shtesë nga subvencionimi për shërbimin universal postar, janë të hyrat të cilat subvencionohen nga MZHE sipas Marrëveshjes që Posta e Kosovës ka me Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe të cilat për vitin 2020 kapin vlerën prej 4,298,299.52 euro. Po ashtu Divizioni i Ankesave sipas dokumentacionit në dispozicion konstaton se Posta e Kosovës, ka ndarë shpenzimet që janë bërë në kuadër të shpenzimeve universale postare me subvencion dhe nëse analizojmë zërin e pagave si shpenzimi më i lartë, Posta e Kosovës pagat e shërbimeve universale postare me subvencion i ka ndarë në konto të veçantë kontabël, ndërsa pagat pa subvencion të shërbimeve universale postare i ka njohur bashkë me pagat e shërbimeve tjera postare, pra në kuadër të shpenzimeve të pagave pa subvencion ka edhe paga të shërbimit universal postar që nuk janë objekt i subvencionimit dhe si ti tilla ka paraqitur bashkë me pagat

e shërbimeve tjera postare. Po ashtu te zërat tjerë që hynë në kuadër të kontos 4902-të hyrat nga subvencioni për shërbime universal postar si shpenzimet e karburanteve, shpenzimet e mjeteve motorike etj. Një pjesë e këtyre shpenzimeve sipas marrëveshjes me MZHE-në subvencionohet nga qeveria kurse një pjesë mbulohen nga të hyrat që janë realizuara nga shërbimet universale postare.

Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr.381/22 të datës 03.05.2024 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiar A.M. me detyra përkatëse.

Nga mendimi dhe konstatimet e nxjerra nga eksperti financiar në ekspertizën financiare të datës 18.06.2024, është dhënë mendimi profesional ku i njëjti ka konstatuar se: *“Vendimi mbi Njoftim-Rivlerësimet e kontrollit tatimor nga ATK përmes Raportit të Kontrollit nr. 2/2021, datës 25.05.2021, për rritjen e qarkullimit shtesë ndaj Postës së Kosovës, përkatësisht prezantimi i të hyrave shtesë në vlerë prej 4,298,202.52 euro në PF të PK-së për vitin që përfundon më 31.12.2020, nuk është i mbështetur në bazë të vlerësimeve dhe analizave të prezantuara më lartë. Ky konstatim është mbështetur në shqyrtimin e hollësishëm të pasqyrave financiare 2020 të pranuar nga Posta e Kosovës, si dhe në vlerësimin dhe konfirmimin e ARKEP-it për PF të Postës së Kosovës për vitin 2020. Po ashtu, përgjigja nga Ministria e Ekonomisë thekson se Posta e Kosovës nuk është subvencionuar deri më tani në emër të mbulimit të humbjes për ofrimin e shërbimeve universale postare dhe nuk ka mjete të planifikuara për këtë qëllim për vitin 2020, 2021 dhe 2022, pasi që nuk janë përmbushur kushtet dhe kriteret ligjore të parapara për subvencionimin në emër të ofrimit të SHUP. Rrjedhimisht, sipas konstatimit më lart, Posta e Kosovës nuk ka qenë e obliguar të prezantojë të hyra ose qarkullim shtesë në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon më 31.12.2020 në shumën e vlerësuar nga raporti i kontrollit prej 4,298,202.52 euro, e cila ishte objekt i padisë së Postës dhe çështje kontesti mes dy palëve dhe objekt i trajtimit të kësaj ekspertize.”*

Në seancën në shqyrtimin gjyqësor kryesor publik të datës 19.09.2024 eksperti financiar A.M. ka deklaruar se: *“Mbetem në tërësi në deklaratimet e bëra me shkrim në ekspertizën financiare të dorëzuar gjykatës me datë 18.06.2024 me të cilën janë dhënë konstatimet bazuar në provat dhe shkresat e lëndës si dhe duke iu referuar ligjeve përkatëse, rregullave të ARKEP, si dhe ligjeve*

*tjera relevante për çështjen e cila është objekt i ekspertizës. Duke qenë një lëndë komplekse është bërë një punë e madhe e që ka marrë shumë kohë pikërisht vetëm për të definuar dhe sqaruar në mënyrë profesionale çështjet përkatësisht detyrat e definuara nga gjykata përmes aktvendimit KF.nr.381/22.”.*

E paditura me 16.09.2024 e ka kundërshtar ekspertizën financiare duke theksuar se e gjithë ekspertiza financiare është e bazuar në pasqyrat financiare të vitit pasues e të cilat nuk janë objekt i kontrollit tatimor si dhe nuk kanë qenë të dorëzuara gjatë periudhës së kontrollit, me kërkesë që gjykata mos ti fal besimin kësaj ekspertize financiare.

Gjykata e ka pranuar ekspertizën financiare të datës 18.06.2024 të ekspertit financiar A.M. në tërësi si të besueshme, me që e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë. Gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit kontestues është i mangët dhe po ashtu nuk janë elaboruar të gjitha çështjet dhe faktet vendimtare që kanë të bëjnë me këtë konflikt administrative. Nga vendimi i kontestuar shihet se ai përmban të meta, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo te plota. Në arsyetimin e tij nuk janë dhëna arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kontestuar. Nga ekzaminimi i vendimit kontestues në arsyetim të tij, e paditura ka theksuar se nga analiza e bërë dosjes dhe sqarimeve shtesë të pranuar nga kontrolli vërteton se tek zërat të cilat janë të përfshirë tek kontoja 4902-të hyrat nga subvencionimi për shërbimin universal postar, janë të hyrat të cilat subvencionohen nga MZHE sipas marrëveshjes që Posta e Kosovës që ka me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomi dhe të cilat për vitin 2020 kapin vlerën prej 4,298,299.52. Gjykata konstaton se paditura nuk e ka vërtetuar saktë gjendjen faktike, për arsye se nga përgjigja e Ministrisë së Ekonomisë të dhëna ekspertit financiar A.M. me datë 22.05.2024 me anë të e-mailit ka theksuar se *“Ministria e Ekonomisë nuk e ka paguar këtë shërbim dhe me Ligjin e Buxhetit për vitin 2020 dhe planifikimi për vitet 2021-2022, nuk ka pasur buxhet të ndarë për këtë shërbim”*. Andaj për gjykatën është i papranueshme konstatim i të paditurës, për arsye se e paditura nuk ka argumentuar me asnjë fakt apo prove nëse paditësi është subvencionuar në emër të mbulimit të humbjes për ofrimin e shërbimeve universale postare për vitin 2020, pra a është subvencionuar në emër të ofrimit të SHUP nga Ministria e Ekonomisë (MZHE në atë kohë), por vetëm ka theksuar se janë të hyrat të cilat subvencionohen nga MZHE sipas marrëveshjes që Posta e Kosovës ka me MZHE, pa vërtetuar se a ekziston kjo marrëveshje dhe a është subvencionuar paditësi, andaj një vendim i tillë nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative.

Duke u referuar në dispozitat e nenit 43 të LKA-së, ku parashihet se gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, gjatë procedimit të provave materiale në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata nuk posedon argumente në të cilat është bazuar organi i paditur.

Gjykata vlerëson, se arsyetimi i vendimit nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim dhe nuk përmban të dhëna lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe provat me të cilat është vërtetuar gjendja faktike nuk janë vërtetuar, si dhe nuk përmban arsye përkitazi me thëniet në padinë e paditësit. Në këtë drejtim gjykata konsideron se pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese dhe pa e mbështet vendimin kontestues në prova të cilat e vërtetojnë qartë gjendjen faktike e paditura nuk ka mundur të nxjerr konkluzion të drejtë në këtë çështje administrative.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara më lart.

Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, “*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit*”. Neni 7, paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në përputhje me nenin 43, paragrafi 1, të LKA-së. Në bazë të këtij parimi, gjykata e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar.

Andaj gjykata aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Sipas nenit 43, paragrafi 2, të LKA-së, përcaktohet se: *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulohet me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”*. Andaj, gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43, paragrafi 2, të LKA-së e detyron të paditurën që në ri-procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar edhe në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë të bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata konform nenit 43, paragrafi 2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.381/22, datë 19.09.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.